

NJOFTIM
Nr. 8351, datë 5.6.2017

PËR BOTIMIN E DATËS SË HYRJES NË FUQI TË DY MARRËVESHJEVE

Më datën 5 maj 2017 kanë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare si vijon:

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, 2013, 2014, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve”, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 30/2017, i cili është shpallur me dekretin nr. 10119, datë 7.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve II”, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 31/2017, i cili është shpallur me dekretin nr. 10120, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
Gazmend Barbullushi